

Analizë e filosofisë së riteve islame

Ajetullah Muhammed Bakir el-Sadr

Ritet gëzojnë një rol të rëndësishëm në Islam. Urdhëresat e tyre përfaqësojnë një pjesë të rëndësishme të jurisprudencës dhe të adhurimit, që përbën një dukuri të spikatur në përditshmërinë e njerëzve të përzotshëm.

Sistemi i riteve në jurisprudencën islame përfaqëson një prej aspekteve të pandryshueshme të saj, të cilat s'mund të ndikohen nga prirjet e përgjithshme të jetës apo rrethana të tjera të përparimit shoqëror në jetën e njeriut, përveç një pjese të vogël, ndryshe nga aspektet e tjera juridike që janë fleksibël dhe dinamike. Metoda e përdorimit dhe vënies në punë të këtyre aspekteve juridike ndikohet nga rrethanat që lidhen me përparimin shoqëror në jetën e njeriut, siç është për shembull sistemi i ndërveprimeve (mu'amelat).

Në sferën e adhurimit, njeriu i periudhës së elektricitetit dhe hapësirës lutet, agjëron dhe kryen haxhin ashtu siç lutej, agjëronte dhe kryente haxhin paraardhësi i tij i periudhës së mullirit prej guri.

Gjithsesi është e vërtetë që, në aspektin shoqëror të përgatitjes për të kryer një rit, ndryshimi qëndron në faktin se, ndërkohë që njëri udhëton për tek vendi i tij i haxhit me avion, tjetri udhëtonte me karvan devesh. Dhe ndërsa njëri e mbulon trupin, gjatë namazit apo në raste të tjera, me cohë të prodhuar nga makineritë, tjetri mbulonte trupin me rroba të qepura me dorë. Por, formula e përgjithshme e adhurimit, si dhe metoda e legjislimi i tij janë të njëjta. Nevoja e zbatimit të tij nuk ka pësuar kurrë ndryshim dhe as vlera e tij legjislative nuk është ndikuar apo tronditur nga rritja e vazhdueshme e kontrollit të njeriut mbi natyrën dhe mjetet e tij të jetesës.

Kjo do të thotë që Sheriati islam nuk i ka urdhëruar namazin, agjërimin, haxhin dhe ritet e tjera islame përkohësisht apo si formulë juridike që kufizohet në kushtet ku ky Ligj është zbatuar në periudhat e hershme të historisë. Përkundrazi, këto rite i janë urdhëruar njeriut që përdor energjinë atomike për të vënë në lëvizje motorin, ashtu siç i janë urdhëruar njeriut që plugonte fushën me parmendë.

Së këtejmi nxjerrim përfundimin se sistemi i riteve ka të bëjë me nevojat në jetën e njeriut, për të cilin ato janë krijuar dhe mbeten të pandryshueshme pavarësisht përparimit të vazhdueshëm në mënyrën e jetesës së njeriut. Kjo sepse zbatimi i një urdhërese të pandryshueshme kërkon një nevojë të pandryshueshme. Nga kjo lind pyetja:

A ka ekzistuar në të vërtetë një nevojë e pandryshueshme në jetën e njeriut që kur jurisprudenca ka nisur rolin e saj kultivues, që të ketë mbetur e tillë deri më sot, në mënyrë që të mund të interpretojmë – në kuadrin e qëndrueshmërisë së saj – qëndrueshmërinë e formulave me të cilat jurisprudenca e ka trajtuar dhe përmbushur këtë nevojë, në mënyrë që në fund të mund të shpjegojmë qëndrueshmërinë e adhurimit në rolin e tij pozitiv për jetën e njeriut?

Në pamje të parë mund të duket se sugjerimi i një nevoje të tillë të pandryshueshme është i papranueshëm dhe se nuk përputhet me realitetin jetësor të njeriut të sotëm apo atë të njeriut të së ardhmes. Është e qartë që njeriu largohet përherë e më tepër – sa i përket mënyrës, natyrës së problemeve dhe faktorëve të progresit të jetës së tij – nga rrethanat e një shoqërie fisnore, problemet e tij pagane, shqetësimet, aspiratat e kufizuara dhe mënyra e trajtimit dhe organizimit të këtyre nevojave, në kuadrin e të cilave lindi jurisprudenca përmbyllëse. Atëherë, si mundet që ritet – në sistemin e vet të veçantë juridik – të përmbushin një rol të vërtetë në këtë fushë që është bashkëkohëse e jetës së njeriut, pavarësisht progresit të gjerë në mjetet dhe mënyrat e jetesës? Nëse rite të tilla si namazi, abdesi, banja rituale (gusl) dhe agjërimi kanë qenë të dobishme në një fazë të caktuar të jetës së një beduini – duke ndikuar në kultivimin e sjelljes së tij, angazhimin e tij praktik për ta pastruar trupin dhe ruajtur atë nga teprimet në të ngrënë e në të pirë – po këto synime, për të njëjtën arsye, njeriu i sotëm i arrin përmes natyrës së jetës së tij të qytetëruar dhe normave të jetës sociale. Pra, duket se këto rite nuk janë më aq të domosdoshme sa ç’kanë qenë dikur dhe nuk kanë më rolin që kishin në ndërtimin e qytetërimit apo zgjidhjen e problemeve të ndërlikuara!

Por kjo teori është e gabuar. Progresi shoqëror në mjete dhe vegla pune – për shembull, nga punimi i tokës me dorë tek makina me avull apo ajo elektrike – dikton ndryshim në marrëdhënien e njeriut me natyrën dhe me të gjitha trajtat e saj materiale. Marrim si shembull bujqësinë, e cila përfaqëson marrëdhënien mes tokës dhe bujkut. Ajo zhvillohet materialisht në formë dhe përmbajtje në bazë të normës së zhvillimit të përshkruar më lart.

Ndërkohë që adhurimi nuk është marrëdhënie mes njeriut dhe natyrës, që të mund të ndikohet nga ky lloj zhvillimi apo progresi. Përkundrazi, është marrëdhënie mes njeriut dhe Zotit të tij. Kjo marrëdhënie ka një rol shpirtëror që udhëheq marrëdhënien e njeriut me të ngjashmit e vet. Megjithatë, në të dyja rastet shohim se, historikisht, njerëzimi ka jetuar me një numër të caktuar nevojash të pandryshueshme me të cilat është përballur njëlloj si njeriu i kohës së vajit (d.m.th. kur vaji shtazor përdorej për ndriçim) ashtu edhe njeriu i kohës së elektricitetit. Sistemi i riteve në Islam është zgjidhja e pandryshueshme e nevojave të pandryshueshme të këtij lloji dhe sa i përket problemeve natyra e të cilave nuk është e vazhdueshme, ato janë probleme me të cilat njeriu përballlet gjatë zhvillimit të tij individual, shoqëror dhe kulturor. Një zgjidhje e tillë, që përmbledhet me emrin “rite” (ibadat), është ende e gjallë në objektivat e saj edhe sot, duke u bërë një kusht i domosdoshëm që njeriu të kapërcejë problemet e tij dhe të ushtrojë me sukses prirjet e tij të qytetëruara.

Prandaj, që ta kuptojmë më mirë këtë, duhet të theksojmë disa nevoja dhe probleme të pandryshueshme në jetën e njeriut si dhe rolin që ritet luajnë në përmbushjen e këtyre nevojave dhe kapërcimin e këtyre problemeve.

Këto nevoja janë:

1. nevoja për t’u lidhur me Absolutin
2. nevoja për subjektivizëm në qëllim dhe vetmohim
3. nevoja për ndjenjë të brendshme përgjegjësie për të garantuar përmbushjen

Sistemi i riteve është një mënyrë për të organizuar anën praktike të marrëdhënies mes njeriut dhe Zotit të tij, prandaj, ai nuk mund ta ndajë vlerësimin e tij nga kjo marrëdhënie dhe nga roli i saj në jetën e njeriut. Së këtejmi rrjedh se të dyja këto pyetje janë të ndërlidhura:

Së pari: Cila është vlera e arritur nëpërmjet marrëdhënies mes njeriut dhe Zotit të tij në

progresin e tij qytetërues? Dhe, në këtë progres, a kemi të bëjmë me një vlerë të pandryshueshme që përmbush një nevojë të pandryshueshme apo me një vlerë të vazhdueshme që është e lidhur me nevoja të përkohshme apo probleme të kufizuara, e që pastaj e humb rëndësinë e saj në fund të kësaj faze, duke i kufizuar nevoja dhe probleme të tilla?

Së dyti: Cili është roli që luajnë ritet në lidhje me këtë marrëdhënie dhe cilat janë përmasat e rëndësisë së tyre si përkushtim praktik ndaj marrëdhënies mes njeriut dhe Zotit? Më poshtë vijon një përmbledhje e shpjegimeve të nevojshme në lidhje me të dyja pyetjet:

Lidhja mes Absolutes është një problem i dyfishtë

Vëzhguesi, duke qëmtuar me hollësi aktet skenike të historisë së njerëzimit, mund të vërejë që problemet janë të ndryshme dhe shqetësimet variojnë në larmi në formulat e tyre të përditshme. Por, nëse shohim përtej këtyre formulave, duke depërtuar në thellësinë dhe thelbin e problemit, do të gjejmë një problem kryesor esencial dhe të pandryshueshëm me dy tehe apo kahe të kundërta, prej të cilit njerëzimi ka vuajtur gjithmonë gjatë përparimit të tij qytetërues në histori. Nga njëri këndvështrim, problemi është humbja dhe mosekzistenca, që është ana negative e tij. Nga ana tjetër, problemi është i skajshëm në ekzistencë dhe përkatësi. Kjo shprehet duke lidhur faktet relative me të cilat njeriu i përket Absolutit, duke shprehur kështu anën pozitive të të njëjtit problem. Jurisprudenca Përmyllëse (e Islamit) i ka vënë emrin “ateizëm” problemit të parë që shprehet shumë qartë, dhe emrin “idhujtari” dhe Shirk (besim në një ose shumë të ngjashëm me Zotin), që është gjithashtu një shprehje shumë e qartë e tij. Beteja e vazhdueshme e Islamit kundër ateizmit dhe Shirkut është, në realitetin e saj të qytetëruar, një betejë kundër të dyja anëve të problemit në përmasat e tyre historike.

Të dyja këndvështrimet e problemit takohen në një pikë thelbësore që është: largimi i përpjekjeve përparuese të njeriut nga një krijimtari imagjinate e vazhdueshme dhe e mirë. Problemi i humbjes për njeriun do të thotë se është në humbje të vazhdueshme dhe se nuk i përket Absolutit, tek i Cili ai nuk mund të mbështetet në udhën e tij të gjatë e të vështirë, duke përfutur ndihmë nga Absoluti dhe kujdesi i Tij, mjetet e jetesës dhe një vizion të qartë të qëllimi dhe duke ia përngjitur, nëpërmjet këtij Absoluti, lëvizjen e vet gjithësisë, të gjithë ekzistencës, përjetësisë dhe amëshimit, duke përvijuar marrëdhënien e tij me Atë dhe pozitën e tij në skemën gjithpërfshirëse kozmike. Lëvizja në humbje pa ndihmën e një Absoluti është thjesht një lëvizje e rëndomtë si ajo e një puple ne erë, tek e cila ndikojnë dukuritë që e rrethojnë ndërkohë që ajo është e paaftë të ndikojë tek ato. Nuk ka arritje apo prodhimtari në ecjen madhështore të njeriut përgjatë historisë pa një lidhje dhe pa shkrirje me një Absolut në një ecje objektive.

Nga ana tjetër, po kjo lidhje, udhëheq anën tjetër të problemit, atë të entitetit skajimor, duke kthyer “relativen” në “absolute”, një problem me të cilin njeriu përballet pareshtur. Njeriu e lidh besën e tij me një rast në mënyrë që ajo forcohet dhe zhvishet nga tiparet e saja relative, brenda të cilave ai ishte i saktë dhe mendja njerëzore do të deduktojë prej saj një “absolut” pa fund, pa i vënë kufi përgjigjes së tij ndaj kërkesave të saj.

Në terminologjinë fetare, një “absolute” e tillë herëpashere kthehet në një “zot” që adhurohet në vend të një nevojë që kërkon përmbushje. Kur “relativja” shndërrohet në “absolute”, në një “zot” të këtij lloji, ajo bëhet faktor rrethues i lëvizjes së njeriut, duke i ngrirë aftësitë e saj zhvilluese dhe krijuese, duke e penguar njeriun për të luajtur rolin e tij të natyrshëm në ecjen

përpara: {Dhe mos shoqëro me Allahun ndonjë zot tjetër, e të bëhesh i harruar!} (Kur'an, XVII:22)

Ky është një fakt i vërtetë që vlen për të gjithë “zotat” që ka krijuar njerëzimi gjatë historisë së tij, si gjatë fazës idhujtare të adhurimit ashtu edhe në vijueset. Nga faza e fisit tek ajo e shkencës gjejmë një sërë “zotash” të cilët njerëzimi i ka trajtuar si një “absolute” dhe të cilët i kanë penguar popujt që i kanë adhuruar nga progresi i duhur. Konkretisht, nga fisi të cilit njeriu i dha besën, duke e konsideruar si nevojë aktuale të diktuar nga rrethanat e veçanta të jetesës, ai shkoi në ekstremin tjetër, duke e shndërruar atë në një “absolute”, pa qenë në gjendje të shohë gjë tjetër përveçse nëpërmjet tyre. Për rrjedhojë ata u bënë pengesë në rrugën e tij të progresit.

Ndërsa njeriu i sotëm, me të drejtë, e lidhi besën me shkencën, meqenëse kjo i hapi atij rrugën drejt nënshtrimit të natyrës. Por ai, herë pas here e teproi me këtë aleancë të tijën, duke e kthyer në aleancë absolute nga e cila u magjeps, një “absolute” për t’u adhuruar, duke i ofruar asaj ritet e bindjes dhe besnikërisë, duke flakur tej për hir të saj të gjitha idealet dhe faktet që nuk mund të maten kurrë me metra apo të shihen me mikroskop.

Për këtë arsye, çdo gjë e kufizuar dhe relative, nëse njeriu do t’i rrinte larg, në njëfarë faze, një absolute me të cilën ai e identifikon veten, në një fazë të pjekurisë intelektuale bëhet prangë për mendjen që e ka krijuar, për shkak natyrës së saj të kufizuar dhe relative. Prandaj, ecja përpara e njeriut duhet të ketë një Absolute.

Dhe kjo duhet të jetë një Absolute e vërtetë e aftë për të përthithur ecjen e njeriut, duke e drejtuar në rrugën e drejtë pavarësisht nga përparimi që arrin apo sa larg shkon në rrugën e saj të gjatë, duke spastruar të gjithë “zotat” që rrethojnë dhe pengojnë ecjen.

Në këtë mënyrë, problemi mund të zgjidhet në të dyja anët e tij. Kjo zgjidhje rrjedh nga ajo që Jurisprudenca Hyjnore i ka paraqitur njeriut në tokë: besimin në Zot si Absoluti me të Cilin njeriu i kufizuar mund ta lidhë ecjen e tij pa pësuar asnjë kontradiktë në rrugën e tij të gjatë.

Pra, besimi në Zot zgjidh anën negative të problemit, duke mos pranuar humbjen, ateizmin dhe mosekzistencën, duke e vënë njeriun në pozitën e përgjegjësisë, me lëvizjen dhe drejtimin e të cilit është i lidhur i gjithë kozmosi. Njeriu bëhet mëkëmbësi i Zotit në tokë. Mëkëmbja nënkupton përgjegjësi dhe shpërbllim të cilin njeriu e merr sipas sjelljes së tij, mes Zotit dhe ringjalljes, pafundësisë dhe përjetësisë, ndërkohë që ai lëviz brenda një sfere të tillë përgjegjësish dhe lëvizjesh të qëllimshme.

Besimi në Zot zgjidh gjithashtu dhe aspektet pozitive të problemit – ato të ekzistencës ekstreme, duke imponuar kufizime tek njeriu dhe duke e zbutur ecjen e tij të shpejtë – në këtë mënyrë:

Së pari: Ky aspekt i problemit krijohet duke shndërruar të kufizuarën dhe relativen në një “absolute” nëpërmjet ushtrimit të intelektit dhe duke e zhveshur relativen nga rrethanat dhe kufizimet e saj. Përsa i përket absoluteve që sjell besimi në Zot, kjo nuk ka qenë kurrë sajese e një faze të intelektit njerëzor; që ajo të bëhet, në një fazë të re të pjekurisë intelektuale, e kufizuar tek mendja që e ka krijuar. Dhe as që ka qenë ndonjëherë pjellë e një nevojë të kufizuar të një individi apo grupi, që absolutizimi i saj ta kthejë në armë në duart e një individi apo grupi për të garantuar interesat e tyre të paligjshme. Sepse Zoti, i Lavdëruari, i

Larti, është një Absolute pa kufij, Cilësitë e përhershme të të Cilit përthithin të gjitha idealet më të larta të njeriut, mëkëmbësit të Tij mbi tokë, të të kuptuarit dhe dijes, aftësisë dhe fuqisë, të drejtësisë dhe mirëqenies. Kjo do të thotë që rruga për tek Ai është pa kufizim; prandaj, ecja drejt Tij kërkon vazhdimësinë dhe lëvizjen relative dhe një përshpejtim relativ të njeriut të të kufizuarit (njeriut) drejt Absolute (Zotit) pa pushim.

{O ti njeri, vërtet ti përpiqesh me një përpjekje të madhe drejt Zotin tënd, e Atë do ta gjesh.} (Kur'an, LXXXIV:6)

Ai i jep kësaj lëvizjeje idealet e Tij të larta që rrjedhin nga të kuptuarit, dija, aftësia dhe drejtësia, si dhe cilësi të tjera të asaj Absolute, drejt së Cilës është e drejtuar ecja. Ecja drejt Absolute është e gjithë dija, gjithë potenciali, e gjithë drejtësia dhe e gjithë pasuria. Domethënë, ecja njerëzore është një luftë e pandërprerë kundër të gjitha llojeve të injorancës, paaftësisë, shtypjes dhe varfërisë.

Për sa kohë që këto të jenë qëllimet e ecjes të lidhur me këtë Absolute, ato nuk janë thjesht një përkushtim ndaj Zotit, por gjithashtu një betejë e vazhdueshme për hir të njeriut, për dinjitetin e tij, për arritjen e idealeve të tilla të larta për të:

{E kush përpiqet për të mirë, ai bën luftë për vete, se Allahu vërtet nuk ka nevojë për askënd në tërë krijimin} (Kur'an, XXIX:6)

{...kush orientohet në rrugën e vërtetë, ai e ka për vete e kush e humb, ai i bën dëm vetëm vetes, e ti nuk je garantues i tyre.} (Kur'an, XXXIX:41)

Përkundrazi, absolutja iluzore dhe zotat e rremë nuk mund ta përfshijnë ecjen me të gjitha aspiratat e saj, sepse këto absolute të sajuara janë pjellë e trurit të njeriut të paaftë, apo nevojës së njeriut të varfër, apo shtypjes së shtypësit; prandaj të dyja janë të lidhura me injorancën, paaftësinë dhe shtypjen. Ato nuk mund ta bekojnë kurrë luftën e vazhdueshme të njeriut kundër tyre.

Së dyti: Të qenit e lidhur me Zotin e Plotfuqishëm si Absoluti që përfshin të gjitha aspiratat e ecjes njerëzore do të thotë njëkohësisht edhe refuzim i të gjitha atyre absoluteve imagjinare që shkaktonin ekzistencë të tepërt. Gjithashtu do të thotë të shpallësh luftë të vazhdueshme dhe betejë të pafund kundër të gjitha llojeve të idhujtarisë dhe adhurimit artificial. Në këtë mënyrë, njeriu do të mësojë të ketë kujdes nga këto absolute fallso të cilat i ishin bërë pengesë në rrugën e tij drejt Zotit, duke ia përçudnuar qëllimin dhe duke e rrethuar ecjen e tij: {E veprat e atyre që nuk besuan janë si mirazhi në rrafshinë ku i etshmi mendon se është ujë derisa kur t'i afrohet nuk gjen asgjë, por aty e gjen Allahun dhe Ai do t'ia japë llogarinë e tij. Allahu është i shpejtë në llogaritje} (Kur'an, XXIV:39)

{A është më mirë të adhurohen zota të ndryshëm ose Allahu, i vetmi ngadhënjimtar? Ata që ju adhuronin përveç Allahut, nuk janë tjetër vetëm se emra që pagëzuan ju dhe prindërit tuaj, për të cilët Allahu nuk shpalli ndonjë fakt} (Kur'an, XII: 39-40)

{Ky është Allahu, Zoti juaj, i tërë sundimin është i Tij, e ata që i lutni në vend të Tij, nuk posedojnë as sa një cipë} (Kur'an, XXXV:13)

Po të analizojmë moton kryesore që Zoti ka paraqitur në lidhje me këtë: “Nuk ka zot veç Zotit,” do të shohim që kjo lidh ecjen njerëzore me Absoluten e Vërtetë, duke hedhur poshtë

çdo absolute të rreme. Historia e ecjes, në aktualitetin e saj të sotëm, përgjatë periudhave të saj ka theksuar lidhjen organike mes këtij refuzimi dhe asaj lidhjeje të fortë dhe të vetëdijshme me Zotin e Plotfuqishëm. Për sa kohë që largohet nga Zoti i Vërtetë, njeriu zhytet në labirintin e zotave dhe padronëve të ndryshëm. Si refuzimi, ashtu edhe lidhja pozitive me “Nuk ka zot përveç Zotit” janë veçse dy anët e të njëjtit fakt: faktit që është i domosdoshëm për ecjen njerëzore përgjatë rrugës së saj të gjatë. Nuk është tjetër veçse e Vërteta që vlen për ta shpëtuar ecjen nga humbja, duke e ndihmuar atë të shfrytëzojë të gjitha energjitë krijuese dhe vetëdijësuar atë për çdo absolute e rreme dhe penguese.

Ritet janë shprehje praktike

Ashtu siç njeriu lind duke mbartur të gjitha potencialet e përvojës në skenën e jetës, si dhe të gjitha farat e suksesit të tij, si vetëdija, veprimtaria dhe kushtëzimi, ai lind gjithashtu edhe me një lidhje të natyrshme me Absolutin. Kjo për arsye se marrëdhënia e tij me Absolutin është një nga kërkesat e suksesit të tij me të cilin ai kapërcen problemet që has ecja e tij e qytetëruar, siç e kemi parë tashmë dhe nuk ka përvojë më ushqyese dhe përfshirëse, më kuptimplote, se ajo e besimit (iman) në jetën e njeriut. Kjo ka qenë një dukuri bashkëshoqëruese e njeriut qëkur s’mbahet mend. Gjatë të gjitha fazave të historisë, një bashkëshoqëruese e tillë shoqërore dhe e pandërprerë tregon, nëpërmjet përvojës, që shkuarja drejt Absolutit, aspirimi drejt Tij nga përtej kufijve të shkelur nga njeriu është një prirje e çiltër e njeriut pavarësisht nga larmia e këtyre prirjeve, metodat e tyre dhe shkalla e vetëdijes.

Por besimi, si instinkt, nuk mjafton për të garantuar realizimin e një lidhjeje me Absolutin në formën e saj të duhur, sepse ajo është e lidhur me të Vërtetën nëpërmjet metodës së përmbushjes së një insinkti të tillë. Sjellja e duhur në përmbushjen e tij në mënyrë analoge me të gjitha instinktët dhe prirjet e tjera, duke qenë në harmoni me të, është e vetmja siguri e përfitimit përfundimtar të njeriut. Po kështu, sjellja sipas ose në kundërshtim me një instinkt është ajo që e nxit instinktën, e thellon, e eliminon ose e mbyl atë. E po kështu vdesin farat e mëshirës e dhembshurisë brenda unit të njeriut nëpërmjet keqardhjes së vazhdueshme e praktike për të mjerët, të shtypurit dhe të varfërit.

Nga ky këndvështrim, besimi në Zot, ndjenja e thellë e aspirimit drejt të panjohurës dhe lidhjes me Absoluten duhet të kenë një drejtim që përcakton mënyrën e përmbushjes së një ndjenje të tillë dhe metodën e thellimit dhe rregullimit të saj në përputhje me të gjitha ndjenjat e tjera të sinqerta të njeriut.

Pa një drejtim, një ndjenjë e tillë mund të shkurajohet dhe mund të pësojë devijime të ndryshme, ashtu siç ka ndodhur me ndjenjat e devijuara fetare gjatë pjesës më të madhe të epokave të historisë.

Pa një sjellje të thelluar, një ndjenjë e tillë mund të zvogëlohet dhe lidhja me Absolutin të reshtë së qeni një realitet aktiv në jetën e njeriut, e aftë për të shfrytëzuar energjitë e mira. Feja që paraqiti moton e “Nuk ka zot përveç Zotit,” duke shpallur bashkë me të si mohimin ashtu edhe pohimin, është Drejtuesja.

Ritet janë faktorë që luajnë rolin e thellimit të kësaj ndjenje, sepse ato janë veçse një shprehje praktike e instinktët fetar; nëpërmjet saj, ky instinkt rritet dhe thellohet në jetën e njeriut. Vëmë re gjithashtu që, në ritet e sakta – duke qenë një shprehje praktike e lidhjes me Absoluten – përhapen si pohimi ashtu edhe refuzimi. Në këtë mënyrë, ata janë një pohim i

vazhdueshëm që njeriu i bën lidhjes së tij më Zotin e Plotfuqishëm dhe hedhjen poshtë të çdo “absoluteje” të rreme. Kur njeriu fillon lutjet duke deklaruar se “Zoti është i Madh” (Allahu Ekber), ai e pohon këtë refuzim. Dhe kur ai deklaron se Profeti i Zotit është gjithashtu Robi-Shërbëtori dhe i Dërguari i Tij, ai përsëri e pohon këtë refuzim. Edhe kur përmbahet nga shijimi i kënaqësive të jetës, apo edhe nga shijimi i nevojave për hir të Zotit (si në rastin e agjërimin), duke sfiduar joshjet dhe efektet e tyre, ai pohon këtë refuzim.

Këto rituale kanë arritur të prodhojnë në sferën praktike breza besimtarësh, në duart e Profetit (paqja e ebekimet e Zotit qofshin mbi të) dhe pasuesit e tij të devotshëm, ata lutjet e të cilëve mishëronin në vetvete refuzimin e të gjitha fuqive të liga dhe nënshtrimin e tyre dhe “absolutet” e Kistrës dhe Cezarit u zvogëluan para ecjes së tyre, ashtu siç ka ndodhur me të gjitha “absolutet” e tekave të njeriut.

Në këto rrethana mësojmë se adhurimi është një nevojë e pandryshueshme në jetën e njeriut dhe ecjen e qytetëruar, sepse nuk mund të ketë ecje përpara pa një “absolute” me të cilën të jetë e lidhur, duke përfutur prej kësaj idealet e saj. Dhe nuk ka “absolute” që të mund të përthithë ecjen përgjatë rrugës së saj të gjatë përveç Absolutit të Vërtetë (Zotit), të Lavdishmit. Përveç Tij, “absolutet” e rreme krijojnë përfundimisht, në një mënyrë a një tjetër, një absolute e cila e mban nën fre përparimin. Pra, përngjitja me Absoluten e Vërtetë është një nevojë e pandryshueshme. Dhe nuk mund të ketë përngjitje me Absoluten e Vërtetë pa një shprehje praktike të kësaj përngjitjeje, që e pohon dhe e fikson atë pareshtur. Një shprehje e tillë praktike nuk është tjetër veçse adhurim. Pra, adhurimi është një nevojë e pandryshueshme.

Subjektiviteti i qëllimit dhe vetëmohimi

Në secilën fazë të qytetërimit njerëzor dhe në secilën periudhë të jetës së njeriut, njerëzit përballen me interesa të shumta, realizimi i të cilave kërkon veprim sasior në një farë shkalle. Sado të larmishme të jenë cilësitë e këtyre interesave apo mënyra e realizimit të tyre nga njëra periudhë në tjetrën, gjithsesi ato mund të ndahen në dy kategori:

1. interesa, përfitimet materiale dhe rezultatet e të cilave shkojnë tek vetë individi, nga puna dhe përpjekjet e të cilit varet arritja e atij interesi;
2. interesa, nga të cilat përfitojnë persona të tjerë dhe jo punonjësi apo grupi të cilit i përket. Në llojin e dytë përfshihen të gjitha llojet e punës që synojnë një qëllim më të madh se ekzistenca e punonjësit vetë, sepse çdo qëllim madhor zakonisht nuk mund të arrihet përveçse nëpërmjet përpjekjeve të përbashkëta për një periudhë të gjatë kohe.

Kategoria e parë e interesave siguron motivin e brendshëm të individit: disponueshmëria dhe përpjekja për ta ruajtur atë, për sa kohë që punonjësi është ai që vjel frytet e interesave dhe i shijon ato drejtpërdrejt është e natyrshme të gjendet tek ai përpjekja për ta ruajtur atë dhe puna për hir të tij.

Sa i përket llojit të dytë të interesave, këtu motivi për t’i ruajtur ato nuk është i mjaftueshëm, sepse këtu interesat nuk janë vetëm ato të punonjësit aktiv; dhe shpesh, pjesa e tij e punës dhe vështirësisë është më e madhe se ajo e interesit madhor. Që këtej, njeriu ka nevojë për një edukim të subjektivitetit të qëllimit dhe vetëmohimit në motiv, dmth, që ai duhet të punojë për hir të të tjerëve, grupit. Me fjalë të tjera, ai duhet të punojë për një qëllim më madhor se ekzistenca e tij dhe interesat materiale vetjake. Një edukim i tillë është njëlloj i nevojshëm si

për njeriun e periudhës së elektricitetit dhe atomit ashtu edhe për njeriun që luftonte me shpatë dhe udhëtonte me deve. Të dy përballen me shqetësimet e ndërtimit dhe të qëllimeve e situatave madhore të cilat kërkojnë vetmohim dhe punë për hir të të tjerëve, duke mbjellë farat frytet e të cilave mund të mos shihen nga ai që i ka mbjellë. Prandaj, është e nevojshme që të nxitet çdo individ që të kryejë një pjesë të kësaj pune dhe përpjekjeje jo thjesht për veten dhe interesat e tija materialiste, në mënyrë që ai të jetë i aftë të kontribuojë me vetmohim, që të synojë një qëllim krejtësisht “objektiv”.

Ritet luajnë një rol madhor në këtë edukim. Këto, siç e kemi parë, janë akte të njeriut të kryera për hir të arritjes së kënaqësisë së Zotit të Plotfuqishëm. Prandaj, ato janë të pavlefshme nëse adhuruesi i kryen thjesht për interesin personal. Ato janë të papërshtatshme nëse qëllimi pas tyre është lavdia personale, admirimi publik, apo përkushtimi për egon, brenda rrethit dhe mjedisit të tij. Në fakt, ato madje bëhen akte të paligjshme që meritojnë dënimit e vetë adhuruesit! E gjithë kjo është për hir të adhuruesi që përpiket, nëpërmjet adhurimit të tij, të arrijë një qëllim objektiv, me gjithçka që nënkupton vërtetësi, sinqeritet dhe ai do t’ia përkushtojë plotësisht adhurimit e tij vetëm Zotit të Plotfuqishëm.

Rruga e Zotit është krejtësisht rruga e shërbimit të mbarë njerëzimit. Çdo vepër që bëhet për hir të shërbëtorëve të Zotit, për Zotin është krejtësisht e mjaftueshme, e pavarur nga shërbëtorët e Tij. Meqenëse Zoti i Vërtetë Absolut është përmbi çdo kufizim, përngjasim, i palidhur me asnjë grup apo anues nga ndonjë drejtim i veçantë, atëherë Rruga e Tij, praktikisht barazohet me atë të të GJITHË njerëzimit. Të punosh për Zotin dhe vetëm për Zotin do të thotë të punosh për njerëzit, për të mirën e të gjithë njerëzve. Kjo është një stërvitje psikologjike dhe shpirtërore që nuk resht kurrë së funksionuari.

Sa herë që përmendet rruga juridike e Zotit, mund të kuptohet njëherazi e gjithë rruga e njerëzimit. Islami e ka bërë Rrugën e Zotit një prej shtigjeve për të shpenzuar zekatin që do të thotë: të shpenzoje për të mirën dhe dobinë e të gjithë njerëzimit. Gjithashtu nxitet përpjekja për Çështjen e Zotit në mbrojtje të të dobtëve, duke e quajtur atë Xhihad, dmth “Lufta në Rrugën e Zotit”.

{Ata që besuan luftojnë në rrugë të All-llahut, e ata që nuk besuan luftojnë në rrugë të së Ligës. Luftoni pra miqtë e Shejtanit, s'ka dyshim se intriga e djallit është e dobët.} (Kur'an, 4:76)

Veç kësaj, nëse mësojmë që adhurimi kërkon lloje të ndryshme përpjekjesh, meqë ai nganjëherë imponon tek njeriu vetëm përpjekje fizike, si për shembull në lutje; dhe nganjëherë psikologjike, si për shembull në agjërim; dhe herë të tjera financiare, si tek zekati; dhe përsëri një përpjekje të katërt në nivelin e vetflijimit apo rrezikut, si tek xhihadi. Nëse i mësojmë të gjitha këto, do të jemi në gjendje të kuptojmë thellësinë dhe aftësinë e stërvitjes shpirtërore dhe psikologjike të ushtruar nga njeriu nëpërmjet riteve të ndryshme për qëllimin objektiv, për dhënien e ndihmesën, për të punuarit për një qëllim më të lartë në të gjitha fushat e përpjekjes njerëzore.

Bazuar në këtë mund të gjendet ndryshimi i gjerë mes një njeriu që është rritur duke bërë përpjekje për të kënaqur Zotin, të edukuar me punën pa prituri shpërblim dhe atij që është rritur duke e matur çdo punë sipas sasisë së interesave personale që mund të nxjerrë prej saj, duke e bazuar atë në përfitimet që mund të ketë prej saj, duke mos kuptuar – nga kjo matje dhe ky vlerësim – asgjë tjetër veç gjuhës së shifrave dhe çmimeve të tregut. Një njeri i tillë

nuk mund të jetë tjetër veçse tregtar në praktikat e veta sociale, pavarësisht nga fusha apo lloji i tyre.

Duke marrë parasysh edukimin me qëllimin objektiv, Islami gjithmonë e ka lidhur vlerën e një pune me shtysat e veta, duke i ndarë ato nga rezultatet e saj. Vlera e një veprimi në Islam nuk është rezultati apo përfitimi që ai i sjell punonjësit apo gjithë njerëzve, por motivet që fshihen pas tij, pastërtia e tyre, objektiviteti dhe vetmohimi. Për shembull, në rastin e një personi që zbulon ilaçin për një sëmundje të rrezikshme, duke shpëtuar jetët e miliona pacientëve, Zotin nuk e vlerëson zbulimin e tij sipas përmasave të rezultateve të tij apo numrit të pacientëve që ka shpëtuar nga vdekja, por Ai e vlerëson atë sipas ndjenjave dhe dëshirave që kanë prodhuar tek zbuluesi motivin për t'u përpjekur për ta bërë atë zbulim. Nëse ai e ka bërë këtë përpjekje veçse me qëllim që ta shesë atë dhe të fitojë miliona dollarë, kjo vepër e tija nga Zoti konsiderohet njëloj si një veprim thjesht tregtar, sepse logjika egoiste e motiveve egocentrike, ashtu siç e shtynë të zbulojë ilaçin për një sëmundje kronike, shumë mirë mund ta shtyjë për të zbuluar mjete shkatërrimi nëse u gjen atyre një treg që i blen. Një veprim konsiderohet i lavdërueshëm dhe i virtytshëm nëse motivet pas tij e kapërcejnë egon: nëse është për hir të Zotit dhe shërbëtorëve të Tij. Një vepër lartësohet dhe vlerësohet sipas shkallës së vetmohimit dhe pjesëmarrjes së robit të Zotit në kryerjen e saj.

Ndjenja e brendshme e përgjegjësisë

Nëse e vëzhgojmë njerëzimin në çdonjërin prej periudhave të tij historike, do shohim se ai ndjek një sistem të veçantë jete, një mënyrë specifike në shpërndarjen e të drejtave dhe përgjegjësisë mes njerëzve. Do të shohim gjithashtu se sipas sasisë së kërkuar të sigurive që anëtarët e saj të kapen pas këtij sistemi dhe vënies së tij në jetë, do të jetë më afër stabilitetit dhe arritjes së qëllimeve të përgjithshme që priten prej atij sistem.

Ky fakt vlen njëloj si për të ardhmen, ashtu edhe për të kaluarën, sepse është fakt i përcaktuar i ecjes së qytetëruar të njeriut përgjatë hapësirës së saj të gjerë.

Ndër siguritë është ajo që është objektive, siç janë dënimet e imponuara nga grupi për të ndëshkuar individin që shkel kufizimet. Dhe mes tyre është ajo që është e brendshme, pra ndjenja e brendshme e përgjegjësisë që ka njeriu ndaj detyrimeve të tij shoqërore, ndaj çfarëdolloj detyrimi që grupi kërkon prej tij, duke përcaktuar vetiu të drejtat e tij. Në mënyrë që të jetë një fakt i pranishëm në jetën e njeriut, ndjenja e brendshme e përgjegjësisë ka nevojë për besimin në një mbikqyrje, nga njohuria e së cilës nuk shpëton as një atom në tokë apo qiell, si dhe një zbatim praktik nëpërmjet të cilit rritet kjo ndjenjë dhe në bazë të të cilit lëshojnë rrënjë ndjenja të një mbikqyrjeje të tillë gjithëpërfshirëse. Mbikqyrja, së cilës nuk i shpëton asnjë atom, krijohet në jetën e njeriut si rezultat i lidhjes së tij me të Absoluten e Vërtetë, të Gjithëdijshmin, të Gjithpushtetshmin, dija e të Cilit përfshin gjithçka. Kjo lidhje me veten e Tij i kursen njeriut nevojën për një mbikqyrje të tillë, duke mundësuar kështu krijimin e një ndjenje të brendshme përgjegjësie.

Zbatimi praktik, nëpërmjet të cilit rritet kjo ndjenjë e brendshme përgjegjësie, aktualizohet nëpërmjet riteve praktikuese. Sepse adhurimi është detyrë e imponuar nga i Padukshmi dhe me këtë nënkuptojmë që verifikimi i tij nga jashtë është i pamundur. Çfarëdolloj masash nga jashtë për ta imponuar atë do të dështojnë, sepse ai ekziston nëpërmjet qëllimit të vetë vetes dhe angazhimit shpirtëror për të punuar për Zotin; kjo është një çështje që nuk mund të

përfshihet në llogaritjet e një mbikqyrjeje subjektive për së jashtmi dhe atë as që mund ta garantojë ndonjë masë ligjore. Përkundrazi, e vetmja mbikqyrje e suskeshme në këtë aspekt është ajo që rrjedh nga lidhja me Absolutin, të Padukshmin, dijes së të Cilit nuk i shpëton asgjë. E vetmja siguri e mundshme në këtë nivel është ndjenja e brendshme e përgjegjësisë. Kjo do të thotë që personi që praktikon adhurimin po përmbush një detyrë e cila ndryshon nga çdo obligim ose projekt tjetër shoqëror kur ai merr hua dhe kthen borxhin, apo kur bën marrëveshje dhe respekton kushtet. Kur huazon para nga të tjerët dhe pastaj ia kthen dhënësit, ai kryen një detyrë që hyn në kategorinë e monitorimit të mbikqyrjes shoqërore; për rrjedhojë, vlerësimi që ai i bën parashikimit të reagimit shoqëror i dikton atij vendimin për të vepruar kështu.

Detyra rituale, ndaj të Padukshmit, është diçka kuptimin e brendshëm të së cilën nuk e di askush përveç Zotit, të Lavdëruarit, të Gjithfuqishmit, sepse ajo është rrjedhojë e ndjenjës së brendshme të përgjegjësisë. Nëpërmjet praktikave fetare, kjo ndjenjë e brendshme rritet dhe njeriu mësohet që të sillet në përputhje me të. Me anë të kësaj ndjenje mund ta gjejmë qytetarin e mirë. Për një qytetari të mirë nuk mjafton që njeriu të jetë i anktshëm për t'i zbatuar të drejtat ligjore të të tjerëve vetëm për shkak të frikës së tij nga reagimi shoqëror ndaj tij nëse ai nuk e bën këtë. Përkundrazi, qytetaria e mirë arrihet te njeriu që nuk e shpërfill ndjenjën e brendshme të përgjegjësisë.

Në Islam vërejmë që shpesh këshillohet kryerja fshehtazi e jo haptazi riteve jo të detyrueshme. Ka madje edhe rite që për nga natyra janë të fshehta, si agjërimi, sepse ai përbën një nënshtrim të brendshëm që nuk mund të verifikohet për së jashtmi. Ka rite, për kryerjen e të cilave zgjidhet një mjedis i fshehtë, duke shmangur skenën publike, siç janë lutjet jo të detyruara, nafile, të natës, të cilat duhet të kryhen pas mesnatës. E gjithë kjo bëhet për të thelluar aspektin e adhurimit të të Padukshmit, duke e lidhur përherë e më tepër me ndjenjën e brendshme të përgjegjësisë. Kësisoj, kjo ndjenjë thellohet nëpërmjet praktikimit të riteve dhe njeriu mësohet që të sillet në bazë të saj, duke krijuar një garanci të fortë që individi i mirë të përmbushë detyrat dhe obligimet e tij.

Një vështrim i përgjithshëm mbi ritet

Po t'u hedhim një vështrim të përgjithshëm riteve që përmendëm më lart, duke i krahasuar me njëri tjetrin, mund të përftojme disa këndvështrime të përgjithshme të tyre. Ja disa nga këto këndvështrime.

I Padukshmi në shpjegimin e riteve

Më sipër mësuam për rolin e rëndësishëm që adhurimi luan në jetën e njeriut dhe se ai shpreh një nevojë të pandryshueshme në ecjen e tij qytetëruese.

Nga një tjetër këndvështrim: nëse analizojmë dhe shqyrtojmë më kujdes veçantitë, në kuadrin e shkencës së përparuar, do të njihemi me copëzat e urtisë dhe të fshehtat që shpreh jurisprudenca islame në këtë aspekt, të cilat shkenca moderne ka mundur t'i zbulojë.

Kjo marrëveshje e mrekullueshme mes rezultateve të shkencës moderne dhe shumë veçantive të jurisprudencës islame dhe cilatdo rregullave e rregulloreve që ajo ligjëron, shpreh një

mbështetje verbuese për pozitën e kësaj jurisprudence, duke theksuar thelle të qenit e saj e frymëzuar nga Zoti.

Megjithatë, pavarësisht nga gjithë këto, shpesh përballemi me pika të padukshme të adhurimit, pra një grup detajesh e fshehta e të cilave nuk mund të kuptohet nga personi që praktikon adhurimin dhe ai as që mund t'i interpretojë ato materialisht. Pse lutja në perëndim të diellit duhet të ketë tre cikle (rekate), ndërsa ajo e mesditës ka më shumë? Dhe pse duhet që çdo rekat të përfshijë përkuljen një herë e jo dy herë, pse dy sexhde e jo një? E shumë pyetje të tjera si këto.

Këtë aspekt të adhurimit që nuk mund të interpretohet e quajmë “e padukshme”. Këtë aspekt, në një mënyrë a një tjetër, e gjejmë në pjesën më të madhe të riteve që ligjëron jurisprudenca islame. Së këtejmi, mund ta konsiderojmë paqartësinë në kuptim që sapo përmendëm si një dukuri e përgjithshme tek ritet dhe një prej tipareve të tyre më të zakonshme. Kjo paqartësi lidhet njëkohësisht me ritet dhe rolin e tyre të imponuar, sepse roli i riteve, siç mësuam më lart, është theksimi i lidhjes me Absoluten dhe thellimi i kësaj lidhjeje në praktikë. Sa më i madh të jetë elementi i nënshtrimit dhe dorëzimi në një adhurim, aq më i fortë është efekti në thellimin e lidhjes mes adhuruesit dhe Zotit të tij. Nëse veprimi i praktikuar nga adhuruesi kuptohet në të gjitha përmasat e tij, i qartë në urtinë e tij dhe dobinë në të gjitha hollësitë, elementi i nënshtrimit dhe dorëzimit do të minimizohet dhe do të mbizotërohet nga qëllime interesi dhe përfitimi dhe nuk do jetë më adhurim i Zotit por një vepër fitimprurëse e kryer nga adhuruesi që të nxjerrë përfitim prej saj.

Ashtu siç rritet fryma e bindjes dhe besnikërisë së ushtarit, duke u thelluar nëpërmjet stërvitjes ushtarake, duke i dhënë urdhëra dhe duke kërkuar prej tij të veprojë me bindje dhe pa kundërshtuar, ashtu edhe ndjenja e personit adhurues rritet dhe thellohet në lidhjen e tij me Zotin me anë të kërkesës që ai t'i praktikojë këto rite në aspektet e tyre të padukshme me përlulje dhe dorëzim. Sepse përlulja dhe dorëzimi kërkojnë supozimin e ekzistencës së një aspekti të padukshëm dhe orvatjen për të mos e vënë në dyshim këtë aspekt të padukshëm të adhurimit. Të kërkojë interpretimin e tij dhe kufizimin e interesit do të thotë ta zhveshësh adhurimin nga realiteti i tij – si shprehje praktike e bindjes dhe përluljes – dhe ta masësh atë me përmasat e leverdisë dhe interesit si çdo veprim tjetër.

Vërejmë se kjo paqartësi është thuajse e paefektshme në ritet që përfaqësojnë një interes madhor të përgjithshëm, i cili bie ndesh me interesin personal të adhuruesit, si në rastin e xhihadit, i cili përfaqëson një interes madhor të përgjithshëm që bie ndesh me dëshirën e personi që e kryen për të ruajtur jetën dhe gjakun e tij. Kjo ndodh edhe në rastin e zekatit, që përfaqëson një interes madhor i cili bie ndesh me dëshirën e fortë që paguesi i tij ka për të ruajtur pasurinë dhe pronën e vet. Çështja e xhihadit kuptohet shumë mirë nga personi që e kryen atë dhe çështja e zekatit përgjithësisht kuptohet nga personi që e jep. Kësisoj, as xhihadi e as zekati nuk humbasin ndonjë element të përluljes dhe bindjes (ndaj Zotit), sepse vështirësia e sakrificimit të jetës dhe pronës është ajo që e bën pranimin e një adhurimi nga njeriu – për të cilin ai flijon jetën dhe pronën – një vepër të madhe nënshtrimit dhe bindjeje. Shtojmë këtu edhe faktin që xhihadi, zekati e rite të tjera të ngjashme nuk supozohet të jenë thjesht aspekte edukimi për individin, por gjithashtu edhe për arritjen e përfitimeve shoqërore të siguruara në këtë mënyrë. Prandaj, vëmë re se paqartësia theksohet përherë e më tepër në ritet ku mbizotëron aspekti edukues i individit, si lutja dhe agjërimi.

Së këtejmi nxjerrim përfundimin se e padukshmja në adhurim është e lidhur ngushtë me rolin e tij edukues në kapjen e individit pas Zotit të vet, duke e thelluar marrëdhënien e tij me

Zotin.

Kur analizojmë ritet e ndryshme islame, gjejmë në to një element të përfshirjes së të gjitha aspekteve të ndryshme të jetës. Ritet kurrë nuk kanë qenë të kufizuara me norma të veçanta ritualesh dhe as kanë qenë të reduktuara thjesht në nevoja që mishërojnë mënyrën e madhërimit të Zotit, të Lavdëruarit e të Lartit, si përkulja, përgjunja dhe përgjërimi; përkundrazi, ato janë zgjeruar për të përfshirë të gjithë sektorët e veprimtarisë njerëzore. Xihadi, për shembull, është një rit, një veprimtari shoqërore. Zekati është rit, e po ashtu edhe veprimtari njerëzore, konkretisht financiare. Agjërimi është rit, por edhe sistem të ushqyeri. Si abdesi ashtu edhe gusli (banja rituale) janë norma të adhurimit. Ato janë dy mënyra të pastrimit të trupit. Ky aspekt përfshirës i adhurimit shpreh një prirje të përgjithshme të edukimit islam që ka për qëllim lidhjen e njeriut, në të gjitha veprimtaritë e tij, me Zotin e Plotfuqishëm, duke e kthyer çdo vepër të dobishme në adhurim, pavarësisht nga lloji apo fusha. Për të gjetur një bazë të pandryshueshme për këtë prirje, ritet e pandryshueshme janë shpërndarë në fusha të ndryshme të veprimtarisë njerëzore, duke e përgatitur njeriun që ta stërvisë veten për të derdhur frymën e adhurimit në të gjitha veprimet e tij të dobishme dhe frymën e xhamisë në të gjitha vendet e aktivitetit të tij; në fushë, fabrikë, dyqan apo zyrë, për sa kohë që veprimi i tij të jetë i mirë, për hir të Zotit, të Lavdëruarit, të Lartit.

Në këtë aspekt, jurisprudenca islame ndryshon nga dy prirje të tjera fetare: prirja për ta ndarë adhurimin nga jeta dhe prirja për ta kufizuar jetën në një kornizë të ngushtë të adhurimit, siç bëjnë murgjit dhe mistikët.

Sa i përket prirjes së parë, ajo e shkëput adhurimin nga jeta, duke bërë që adhurimi të kryet në vende të krijuara posaçërisht për të. Ajo kërkon që njeriu të jetë i pranishëm në këto vende për ta kryer detyrën e tij ndaj Zotit dhe adhuruar Atë, aq sa kur largohet prej këtyre vendeve, ai i lë shëndenë adhurimit, duke u dhënë pas punëve personale derisa kthehet përsëri te këto vende të shenjtja.

Prandaj, jurisprudenca islame i ka shpërndarë ritet në fusha të ndryshme të jetës, duke nxitur praktikimin e tyre në çdo vepër të mirë. Ajo i shpjegon njeriut që dallimi mes xhamisë, që është shtëpia e Zotit dhe shtëpisë së njeriut nuk qëndron në cilësinë e ndërtimit apo emërtimit; përkundrazi, xhamia e ka merituar të jetë shtëpia e Zotit sepse aty është vendi ku njeriu praktikon një vepër që shkon përtej egos së tij dhe prej të cilës ai synon një qëllim më të lartë se ai që dikton logjika e kufizuar e interesave materialiste dhe se ky vend duhet të zgjerohet për të përfshirë të gjitha aspektet e jetës. Çdo vend ku njeriu kryen një veprim që shkon përtej vetes së tij, dhe që me anë të tij ka për qëllim të arrijë kënaqësinë e Zotit dhe të gjithë njerëzve, mbart, vërtet, frymën e xhamisë.

Sa i përket prirjes së dytë, e cila e redukton jetën në një kornizë të ngushtë adhurimi, ajo përpiqet ta kufizojë njeriun te xhamia në vend që ta zgjerojë kuptimin e xhamisë për të përfshirë të gjitha vendet që dëshmojnë një veprim të mirë të njeriut.

Kjo rrymë mendimi beson se njeriu jeton një konflikt të brendshëm mes shpirtit dhe trupit dhe se ai nuk mund ta arrijë njërin prej këtyre të dyjave. Dualiteti i adhurimit dhe veprimtaritë e ndryshme të jetës e paralizojnë adhurimin dhe pengojnë rolin e tij konstruktiv edukues për të zhvilluar motivet e njeriut dhe arritur objektivin, duke i mundësuar atij që të shkojë përtej egos dhe interesave të ngushta personale në sfera të ndryshme të veprimtarisë. Zoti, i Lavdëruari, i Larti, nuk ka kërkuar kurrë që të adhurohet për hir të Vetes së Tij, sepse Ai është i pavarur nga adhuruesit e Tij që të kënaqet me një adhurim të tillë dhe Ai as që e ka

vënë ndonjëherë Vetes si synim dhe objektiv të ecjes njerëzore që njeriu të mund të përkulë kokën para Tij brenda sferës së adhurimit të tij dhe kaq! Përkundrazi, Ai ka dashur që një adhurim i tillë të ndërtojë njeriun e mirë i cili të jetë i aftë për të shkuar përtej egos së vet, duke luajtur një rol më të madh në ecjen. Arritja shembullore e kësaj nuk mund të arrihet përveçse kur fryma e adhurimit zgjerohet gradualisht tek të gjitha veprimtaritë e tjera të jetës, sepse, siç e kemi parë, zgjerimi i saj nënkupton zgjerim të objektivitetit të qëllimit dhe ndjenjës së brendshme të sjelljes së përgjegjshme, aftësisë për të kapërcyer veten për të qenë në harmoni me njeriun brenda kësaj kornize përfshirëse kozmike, me përjetësinë dhe pavdekësinë që e rrethojnë atë. Përveçse në kurriz të tjetrit. Prandaj, në mënyrë që ai të rritet dhe të ngrihet nga ana shpirtërore, ai duhet ta privojë trupin nga gjërat e mira, duke e zvogëluar praninë e tij në skenën e jetës dhe luftuar pareshtur me dëshirat dhe aspiratat e tij në fusha të ndryshme të saj, derisa të arrijë fitoren mbi të gjitha këto nëpërmjet abstenimit të gjatë, deprivimit dhe praktikimit të disa ritualeve të caktuara.

Jurisprudenca islame e hedh poshtë edhe këtë prirje, sepse ajo i ligjëron ritet për hir të jetës. Jeta nuk mund të konfiskohet për hir të riteve. Në të njëjtën kohë, ajo përpiqet shumë për të bërë të mundur që një njeri i mirë të derdhë gjithë frymën e adhurimit në sjelljen dhe veprimtarinë e tij. Kjo nuk do të thotë se ai duhet të ndërpresë aktivitetet e tij të ndryshme në jetë dhe ta kufizojë veten mes mureve të altarit; përkundrazi, kjo do të thotë që ai t'i shndërrojë të gjitha veprimtaritë e tij në rituale.

Xhamia është thjesht një baze prej ku një njeri i mirë vendos të kyejë sjelljen e tij të përditshme, por ajo nuk kufizohet vetëm tek kjo sjellje. Profeti i Shenjtë (paqja qoftë mbi të) i ka thënë Ebu Dherr el-Ghifarit: “Nëse je në gjendje të hash e të pish për hir të askujt tjetër veç Zotit, atëherë bëje!”

Kështu, adhurimi i shërben jetës. Edukimi dhe suksesi i tij fetar përcaktohet nga zgjerimi i tij, në kuptim dhe frymë, tek të gjitha fushat e jetës.

Adhurimi dhe shqisat

Perceptimi i njeriut nuk ndodh vetëm me anë të shqisave dhe as nuk është thjesht një arsyetim intelektual dhe jomaterial. Ai është një përzierje e arsyes me ndjenjën materiale dhe jomateriale. Kur nga adhurimi kërkohet që të kryejë funksionin e tij në një rrugë me të cilën njeriu ndërvepron në mënyrë të përkryer dhe përmes të cilës është në harmoni me karakterin e tij, adhurimi përbëhet nga një mendje dhe shqisa. Pra adhurimi duhet të përmbajë një aspekt të ndjeshëm dhe një intelekt jomaterial, në mënyrë që të jetë në përputhje me personalitetin e adhuruesit. Po ashtu adhuruesi, gjatë kryerjes së adhurimit e jeton lidhjen e tij me Absolutin me tërë qenien e vet.

Së këtëjmi, qëllimi, ashtu si përmbajtja psikologjike e adhurimit, gjithmonë përfaqëson aspektin e tij intelektual dhe jomaterial, sepse e lidh adhuruesin me Absolutin, të Lavdëruarin, të Lartin. Ka edhe aspekte të tjera të adhurimit që përfaqësojnë aspektin e tij material:

Kibla ndaj së cilës adhuruesi duhet të drejtojë fytyrën gjatë faljes; Harami, që vizitohet si nga ata që kryejnë haxhin ashtu edhe nga ata që bëjnë umren e rreth të cilit kryejnë tavvafin; Safa e Merwa, mes të cilëve vrapon; Xhamratul Akabeh, ku gjuan gurë; Xhamia, që është një vend i krijuar posaçërisht për adhurim;

Të gjitha këto janë të lidhura me shqisat dhe të ngjitura me adhurimin: nuk ka namaz pa një kibël, e as tavvaf pa një Haram, e kështu me radhë, për hir të përmbushjes së pjesës që ka të bëjë me shqisat tek adhuruesi dhe dhënies atij të drejtën dhe pjesën e adhurimit që i takon.

Kjo është rruga e mesme në organizimin e adhurimit dhe formësimit të tij sipas instikteve të njeriut, si dhe përbërjes të tij të veçantë intelektuale e shqisore.

Ai përballet me dy drejtime të tjera: njëri prej tyre shkon në ekstrem në esëllimin e njeriut, nëse mund të thuhet kështu, duke e trajtuar atë sikur ai ka qenë një intelekt jomaterial, përkundër të gjitha shprehjeve ndijore të tij në sferën e adhurimit. Përderisa Absoluti i Vërtetë, i Lavdëruari, nuk kufizohet në kohë dhe hapësirë dhe as nuk mund të përfaqësohet nga një pamje, atëherë Adhurimi i Tij duhet të mbështetet në premisa të tilla dhe në mënyrën që mundëson të menduarit krahasues të njeriut për t'iu drejtuar Absolutit të vërtetë.

Një mënyrë e tillë të menduari nuk miratohet nga jurisprudenca islame, sepse, krahas shqetësimit të saj rreth aspekteve intelektuale që ngre hadithi: “Një orë meditim është më mirë se një vit adhurim,” ajo gjithashtu beson se adhurimi me përkushtim, pavarësisht se sa i thellë, nuk mund ta mbushë plotësisht unin e njeriut apo të zërë kohën e tij të lirë dhe as që mund ta lidhë atë me Absolutin e Vërtetë në të gjithë qenien e tij, sepse njeriu asnjëherë nuk ka qenë thjesht një intelekt.

Nga kjo pikënisje realiste dhe objektive ritet në Islam kanë patur një bazë si intelektuale ashtu edhe ndijore. Personi që kryen namazin praktikon më dëshirë një adhurim intelektual, duke i mohuar Zotit të tij çfarëdo kufizimi apo matjeje. Sepse, kur ai nis namazin me Allahu ekber (Allahu është i Madh), duke e marrë njëkohësisht Qaben e shenjtë si kushtrim hyjnor të cilit ia drejton ndjenjat dhe lëvizjet e tij, ai e jeton adhurimin si me intelekt ashtu edhe me ndjenja, logjikë dhe emocion - si jomaterialisht ashtu edhe intelektualisht.

Prirja tjetër shkon në ekstrem në pjesën që ka të bëjnë me shqisat, duke e shndërruar kushtrimin në një identitet dhe aluzion ndaj realitetit, duke bërë që adhurimi i simbolit të zëvendësojë kuptimin e vërtetë të simbolit dhe të drejtuarit ndaj tij në vend të realitetit që ai tregon; kështu, adhuruesi zhytet, në një mënyrë a një tjetër, në politeizëm dhe paganizëm.

Një prirje e tillë e asgjëson krejtësisht frymën e adhurimit dhe e paralizon funksionin e tij si vegël që lidh njeriun dhe përparimin e tij qytetërues me Absolutin e Vërtetë, duke e shndërruar atë në një vegël që e lidh atë me absolute të rreme, me simbole që, nëpërmjet zhveshjes së rreme intelektuale të çështjes janë shndërruar në një absolute. Në këtë mënyrë, adhurimi i rremë bëhet perdja ndarëse mes njeriut dhe Zotit të tij, në vend që të jetë një lidhje mes tyre.

Islami e ka hedhur poshtë një prirje të tillë, sepse kjo fe e dënon paganizmin në të gjitha format e tij, duke shkatërruar idhujt e tij dhe duke i dhënë fund zotave të rremë, duke mos pranuar asnjë objekt të kufizuar si simbol të Absolutit të Vërtetë, Zotit, të Lavdishmit, apo si personifikim i Tij. Por Islami ka bërë të qartë dallimin mes kuptimit të idhullit që ka shkatërruar dhe Kiblës që ka sjellë, kuptimi i së cilës përçon asgjë më shumë se një pikë e veçantë gjeografike që është përzgjedhur hyjnerisht duke e lidhur atë me namazin, për të kënaqur aspektin e adhuruesit që ka të bëjë me shqisat. Paganizmi nuk është gjë tjetër veçse një përpjekje e devijuar për ta përmbushur këtë aspekt dhe jurisprudenca islame ka qenë në gjendje ta korrigjojë atë, duke sjellë një rrugë të drejtë në harmonizimin mes adhurimit të

Zotit, Absolutit, i Cili nuk ka as kufij e as personifikim, dhe nevojës së njeriut i cili përbëhet prej ndjenjash dhe intelektit - për ta adhuruar Zotin si me ndjenja ashtu edhe me intelekt!

Aspekti social i adhurimit

Në thelb, ashurimi përfaqëson marrëdhënien mes njeriut dhe Zotit të tij. Ai i jep kësaj lidhjeje elementë të mbijetesës dhe qëndrueshmërisë. Por kjo është formuluar në jurisprudencën islame në mënyrë që shpesh e ka bërë atë instrumentale për marrëdhënien mes njeriut dhe të ngjashmit të tij dhe kjo është ajo që ne e quajmë aspekti shoqëror i adhurimit.

Disa rituale, për nga natyra e tyre imponojnë izolimin dhe vendosjen e marrëdhënieve shoqërore mes atyre që e praktikojnë atë ritual. Për shembull, xhihadi kërkon prej adhuruesve që luftojnë për Zotin që të krijojnë mes tyre marrëdhënie të tilla siç do të ndodhte natyrshëm mes trupave të një ushtrie luftarake.

Ka rituale të cilat nuk kërkojnë domosdoshmërisht veprimin në bashkësi (xhema'ah), por pavarësisht nga kjo, ato janë të lidhura, në një mënyrë a një tjetër, me xhema'atin në mënyrë që të krijojnë një përzierje mes marrëdhënies së njeriut me Zotin e tij dhe marrëdhënien e tij me të ngjashmit e vet.

Mes ritualeve të namazit është edhe falja në xhema'at, ku lutja e individit bëhet adhurim i grupit, duke përforcuar lidhjet mes grupit, duke thelluar lidhjet shpirtërore mes tyre nëpërmjet unitetit të tyre në praktikimin e ritualeve.

Po ashtu, kryerja e haxhit ka kohë dhe lokalizim të përcaktuar qartë dhe çdo pjesëmarrës duhet ta praktikojë atë brenda këtyre afateve kohore dhe vendeve, pra, një pjesëmarrje e tillë evoluon si veprimtari madhore shoqërore.